

# KUNNSKAPSLØFTET NGRITJA E DITURIS

Informatë për nxënës dhe prindër:

Cfarë të reja ka në mësim në shkollën fillore dhe në shkollën e mesme nga vjeshta 2006?



## PRINDËR TË DASHUR

- Ju jeni mësuesi i parë dhe më i rëndësishem i femiut tuaj!
- Nëse ju angazhoheni, fëmiju juaj mëson më mirë në shkollë.
- Angazhimi i juaj është po aq rëndësishem në shkollën për të rinj (klasa 7, 8, 9 dhe 10 në shkollën fillore) ashtu si në gjashtë klasat e para të shkollës fillore.
- Në qoftë se ju diskutoni me fëmijun tuaj, atëher ju stimuloni dhe zhvilloni të menduarit e fëmijut.
- Është më rëndësi që ju ta vlerësoni punën e femijve tuaj.
- Kur ju kujdeseni për fëmijën tuaj, atëher fëmija do të është më i motivuar dhe do të ndihet më mirë në shkollë.
- Duke pas parasysh rolin tuaj si prindë dhe mundësin për të ndikuar është shumë e rëndësishme për fëmijën tuaj.
- Nëse ju keni marrëdhënie të mira me shkollën, pra kjo ndikon që fëmija juaj të tregojë rezultate të mira në shkollë.
- Njoftimi i juaj me prinderit të tjerë ndikon në një bashkpunim përcjellje më të mirë.
- Prindërit janë burim i rëndësishëm për shkollimin e femijëve!

Përshendetje nga Këshilli i Prindërve në shkollën fillore (FUG)

## ÇKA ËSHTË NGRITJA E DITURISË?


Ngritja e diturisë është një reformë e re në mësim për shkollën fillore dhe atë të mesme. Reformat sjellin një mori ndryshimesh në shkollë, në strukturën dhe në organizimin e mësimin nga klasa e parë e shkolles fillore deri në klasën e fundit të shkolles së mesme.

Qëllimi i Ngritjes së Diturisë është që të gjithë nxënësit zhvillohen dhe aftësohen në përgjithësi që të mund të jenë aktiv në shoqërinë diturore. Shkolla norvegjeze përfshin të gjithë dhe se ka hapësirë për të gjithë. Të gjithëve duhet dhënë mundësitë e njëjta që të zhvillojnë aftësitë e veta. Ngritja e diturisë do të ndihmojë për të siguruar mësim të përshtatshëm për të gjithë nxënësit dhe ti kushtoj rëndësi arsimimit.

Kjo reformë fillon në gusht 2006 për nxënësit e klases 1. – 9. të shkollës fillore dhe në klasën e parë të shkollës së mesme.

Ndryshimet më të rëndësishme në shkollat norvegjeze që rrjedhin nga "ngritja e diturisë" janë këto:

- Aftësitë themelore forcohen pra... (shiko faqen 7).
- Mësimi në shkrim dhe lexim iu vihet rëndësi që nga klasa e parë.
- Plane të reja mësimore në të gjitha lëndët, pra me qëllime apo pikësnyime të qarta për nxënësit dhe mësimin teoriko - praktikë.
- Lënda e re dhe ndarja e orëve.
- Ofertë e re strukturore për shollat e mesme.
- Vetvendosje sa i përket formave të punës, mjete mësimore dhe organizimi i mësimin.



# NGRITJA E DITURISË FILLON TË PËRDORET NË

## Vitin shkollorë 2006-2007

Nga klasa 1.- 9. të shkollës fillore dhe viti i parë shkollës të mesme fillojnë të përdorin planet e reja mësimore për lëndet e zakonshme dhe lëndet e reja dhe vendosja e tyre në orar. Gjuha e huaj dhe studimi i saj fillon të përdoret gradualisht dhe fillon nga klasa e 8. Shkolla ofron lëndë të cilat nxënësit kanë mundësi apo i zgjedhin vet në shkollën për të rinj ( klasa 7, 8, 9 dhe 10 në shkollën fillore ).

## Viti shkollor 2007-2008

Këto plane mësimore do të vihen në përdorim prej klasës së 10 në shkollën për të rinj dhe në vitin apo klasën e dytë të shkollës së mesme.

## Viti shkollor 2008-2009

Ngritja e diturisë do të vihet në përdorim nga viti apo klasa e tretë e shkollës së mesme. Të gjitha shkollat duhet ofruar lëndë të cilat nxënësit kanë mundësi apo i zgjedhin vet në shkollën për të rinj (klasa 7, 8, 9 dhe 10 në shkollën fillore ).

## Prindërit dhe kujdestarët – janë kontribues të rëndësishëm

Prindërit dhe kujdestarët...

- Janë përgjegjës edhe për mësimin e nxënësve
- Duhet kontribuar me bashkpunim mes shkollës ose me vendin ku zhvillohet mësimi
- Duhet kontribuar në komunikim të ndërsjellët apo dyanshëm për të mirën e nxënësit në zhvillimin profesional dhe social.

Shkolla dhe organizata e pranuar me ligjë për të arsimuar nxënës në praktikë duhet rregulluar mundësin për bashkëpunim me prindërit dhe duke iu dhënë bashkëpërgjegjësi prindërve dhe kujdestarve për shkollim. Shtëpia do të informohet për qellimet mësimore dhe mësimin e lëndëve, si është caktuar të punohet me lëndët mësimore, cilat mënyra të punës përdoren për zhvillimin dhe vlersimin profesional të nxënësve. Duhet rregulluar edhe se si prindërit dhe kujdestarët e fëmijve mund të marrin pjesë në shqyrtimin apo diskutim për zhvillimin e shkollës. Pjesëmarrja e prindërve organizohet nëpër mes këshillit të prindërve dhe komisioneve /këshilleve bashkpunuese lokale dhe Këshillit të Prindërve në shkollën fillore (FUG), ky këshillë pra shtetrorë.



# PLANI MËSIMOR I RI PËR TË GJITHA KLASËT

Plani mësimor për ngritjen e diturisë përfshin krejt mësimin fillorë. Do të zhvillohet një plan mësimor i veçant për ngritjen e diturisë për laponët (samer / samisk) dhe se ky plan do të përdoret në territorin / rajonin administrues lapon.

## Plani i ri mësimor përbëhet nga:

- **Pjesa e përgjithshme**

Pjesa e përgjithshme do ta ketë për bazë mësimin e thelbit të dinjitetit apo vlerës dhe botë kuptimit ndaj njeriut. Ajo pjesë e përgjithshme e planit mësimor që është në fuqi vihet në përdorim edhe në ngritjen e diturisë për shkollën fillore dhe atë të mesme.

- **Parimet mësimore**

Parimet mësimore bëjnë të qartë që pronari i shkollave (gjegjesisht komunat dhe organet administrative të prefekturës apo fylkes) të janë përgjegjës për mësimin në tërësi në përputhje me rregullat dhe pershtatjen e lokaleve shkollorë si dhe kushtet dhe nevojat individuale. Parimet vlejn për të gjitha lëndët dhe të gjitha klasët në shkollat fillore. Shkollat dhe vendët ku zhvillohet mësim shkollorë janë përgjegjëse për zhvillimin dhe kualifikim fillestar të nxënësve dhe atyre nxënësve që mësojnë zanat gjegjesisht: kualifikim social dhe kulturor, motivim që ata të mësojnë dhe strategjit arsimore. Pjesmarja e nxënësit dhe bashkëpunimi me prindërit janë parime tjera të rëndësishme për mësimin.

Pllakati arsimor është njëri ndër parimet mësimore dhe është një përmledhje detyrimeve bazë të shkollës dhe vendit ku zhvillohet mësim.

- **Lëndet shkollorë dhe futja e tyre në orar**


Për shkollën fillore lëndët dhe orari i mësimit është i caktuar dhe i bashkuar për të gjitha klasët e ulëta të shkollës fillore, pra klasave prej (1-7.) si dhe prej klases 8. deri në 10 në shkollën për të rinj të shkollës fillore. Secili pronar i shkollës vecanarisht pra (komunat dhe organet administrative të prefekturës apo fylkes) janë përgjegjës për ndarjen e orëve për secilen shkollë. Lëndët dhe ndarja e orëve është i caktuar për shkollën e mesme për çdo vitë shkollorë.

Për të rritur mundësin e mësimi special apo të vecantë për secilin nxënës (me nevoja të vecanta) pra duhet komuna dhe prefektura apo fylkeja të planifikoj deri në 25 % të orëve të cilat janë të caktuara në lëndë të vecanta.

Ky planifikim do të ndodhë atëherë kur e shihet se kjo ndihmon në arritjen e qëllimit në mësim nga vet nxënësi në përgjithësi. Qëllimet e planit mësimor nuk duhet shmangur apo sajuar edhe nëse janë të planifikuara (për dicka tjetër). Planifikimi i orëve do të bëhet në bashkëpunim me shtëpinë dhe duhet kërkuar pëlqimin e nxënësit dhe nxënësit i cili mëson zanat dhe prindërit e tyre.

- **Plani mësimor për lëndë**

Plani i ri mësimor është i caktuar për të gjitha lëndët e shkollës fillore dhe për lëndët e përbashkëta në shkollën e mesme. Lëndët të cilat nxënësit kanë mundësi apo i zgjedhin vet në shkollat e mesme caktohen më pas apo me kalimin e kohës.



# ELEMENTET TË REJA NË PLANIN MËSIMOR PËR LËNDË

## Aftësimi apo shkathëtsia themelore

Ngritja e dituris do të thotë apo përmbanë që shkollat ti japin përparësi aftësitimit apo shkathëtësive themelore në të gjitha lëndët. Ky është kushtë i rëndësishëm për vazhdimin e mësim. Aftësimi apo shkathëtësit themelore pra janë:

- **Të diturit e shprehjes me gojë**
- **Duhet ditur lexim**
- **Duhet ditur llogaritje**
- **Duhet ditur shprehjen me shkrim**
- **Të diturir e përdorimit te paisjeve digjitale**

Këto kushte janë fut në planin mësimor për lëndë. Për këtë arsye mësuesit janë përgjgjës për zhvillimin e aftësive apo shkathtësive themelore tek nxënësit dhe atyre nxënësve që mësojnë zanat gjatë mësimin të lëndëve të ndryshme. Mësimin të leximit dhe shkrimit prej klasës së parë të shkollës fillore i kushtohet rëndësi nga klasa e parë në shkollën fillore sipas Ngritjes së dituris.

Planet e reja tregojnë qartë se çka duhet zotëruar nxënësit në klasat e ndryshme. Nëpërmjet kompetancave të ngjajshme plani mësimor qartëson ambicionet profesionale për të gjithë nxënësit. Nxënësit qellimin e caktuar mund ta arrijnë në mënyra të ndryshme. Secili nxënës stimulohet në veçanti për të arritur sa më shumë qellimin mësimor nëpër mes mësimin të përshtatshëm, atëherë nxënësi ka drejt për mësim special.

## Gjuha e huaj ose studimi apo thëllimi i gjuhës

Prej vitit shkollor 2006-2007 të gjithë nxënësit e klases 8 do të kenë një gjuhë të huaj të re përveç anglishtes ose studimit apo thëllimit në gjuhën japone, norvegjeze apo angleze.

## Lëndë të cilat nxënësit kanë mundësi apo i zgjedhin vet.

Për ti tërhequr nxënësit e shkollës fillore në lëndë të shkollës së mesme atëherë futen lëndë të cilat nxënësit kanë mundësi apo i zgjedhin vet qysh në shkollën fillore për të rinj pra nga klasa e shtatë e shkollës fillore. Përmbajtja e lëndëve të cilat nxënësit kanë mundësi apo i zgjedhin vet formulohen nga rrethanat në secilën shkollë vecanarishtë dhe si zakonishtë në bashkpunim me shkollat e mesme dhe jetën ekonomike të vendit ku gjendet shkolla. Mësimi mund të bëhet edhe jashtë lokaleve shkollore. Në këtë mënyrë nxënësit fitojnë bazat më të mira për të zgjedhur shkollën e mesme nga interesat dhe provojat që ata përfitojnë nga kjo eksperiencë.

Të gjitha planet mësimore gjenden në faqen e internetit të drejtorisë shkollore  
[www.utdanningsdirektoratet.no/lk06](http://www.utdanningsdirektoratet.no/lk06)

# STRUKTURA E RE E OFERTËS PËR SHKOLLAT E MESME

Shkolla e mesme pos tjerave ka emërtim të ri për disa lëndë ,lëndë përbërse dhe drejtime studijuese nga 2006. Ajo që përpara quhej "drejtimi studijues" tash quhet "programe arsimor", dhe ajo që mëherët quhej "lënda e drejtimit studijues" tani quhet "lënda e cila nxënësit kanë mundësi apo i zgjedhin vet ". Nxënësit bëjnë kërkesë për tu pranuar në një program arsimor , ku më pas ata zgjedhin lëndë të cilat nxënësit kanë mundësi apo i zgjedhin vet.

## **Projekti mbi thëllimin apo studimin e arsimimit profesional**

Sa i përket Ngritjes së dituris dhe hartimi apo përgatitja e planeve të reja pra projekti mbi thëllimin e arsimimit profesional është futë në programet arsimore të mësimi profesional në apo për shkollën e mesme. Pra këtu nxënësi mund të thëllohet apo studijoj atë lëndë të cilën ai apo ajo janë të interesuar më shumë. Projekti mbi thëllimin e arsimimit profesional duhet bërë në bashkëpunim më jetën ekonomike të vendit dhe se nxënësi herët gjatë shkollimit mund të njihet me profesione dhe organizata punuese të cilat janë të pranuar për të arsimuar nxënësit.

## **Nga vjeshta 2006 ofrohen 12 programe arsimore në shkollat të mesme.**

### **Studimet përgaditore për programet arsimore**

(jep kompetencë studiuase, dmth kualifikim për të studijuar në univerzitet apo shkollë të lartë):

- Studime specializuse (më herët pra drejtimi i përgjithshëm,ekonomik dhe administrativ) me lëndë të shkencave natyrore, gjuhës, artit figurativ dhe lëndë natyrore dhe ekonomi.
- Edukatë fizike
- Muzikë, vallëzim dhe dramë

### **Programi arsimor për nxënësit të shkollës profesionale**

(kualifikohet pas një viti plotsuës në vitin e tretë në shkollën e mesme):

- Ndërtimtari dhe teknika e saj
- Dizajnë dhe punim dorës
- Drejtimi i elektros
- Lëndë shëndetsore dhe sociale
- Media dhe komunikimi
- Përdorimi i natyres
- Restaurant dhe lëndë ushqimore / hotelerike
- Shërbimi dhe komunikacioni
- Teknikë dhe prodhime industrijale



# VLERSIMI I NXËNËSVE

Si në shkollën fillore ashtu edhe në shkollën e mesme ekziston rregullorja e përgjithëshme për vlersimin e nxënësit sipas dispozitës në ligjin për arsimim. Këtu ceket se kur duhet dhënë vlersimi pa notë dhe kur duhet vlersuar me notë. Vlersimi me notë përfshin notën e përgjithëshme si dhe notat e provimeve. Në planin mësimor për secilën lëndë është marrë rregullorja mbi notën e përgjithëshme në lëndë dhe se cilat rregulla vlejné për provim në lëndën e përmendur.

## Provimet nacionale dhe hartimet

Qëllimi me provat nacionale është vlersimi nga ana e shkollës dhe se sa ka mundur shkolla të aftësoj apo shkathtësit themelore të nxënësit. Provimet të cilat realizohen duhet të kenë kualitet të lartë profesional dhe rezultatet përdoren si bazë për zhvillimin e kualitetit

shkollorë, tek pronarët e shkollës dhe në nivele regjionale dhe nacionale.

Nga vjeshta 2007 do të zhvillohen provime nacionale në lexim në gjuhën norvegjeze dhe angleze si dhe llogaritja në klasën e 5. dhe 8. Rezultatet e provimeve pasqyrojnë aftësin apo shkathtësit e nxënësit në përputhje me planet mësimore për qëllimin e aftësimit apo shkathtësive themelore pas klasës 4. dhe 7. Rezultatet janë të hapura për ata që punojné me zhvillimin e kualitetit të shkollës, por nuk kanë të drejtë me futë shkollat në ndonjë rënditje sipas kualitetit.

Nga viti shkollor 2006-2007 do të bëhët e obligueshme hartimi në lexim për klasën e 2. Më pastaj do të futen në përdorim edhe hartimet në llogaritjes dhe mirëkuptimin e numrave.

## KUSH DUHET KONTAKTUAR NËSE KENI DONJË PYETJE?

Për pyetjet sa i përket mësimit, mësimin të përshtatur për nxënës me nevoja të vecanta ose organizimin e mësimit në secilën shkollë. Pra këto pyetje duhet bërë mësuesve ose rektorit / drejtorit, eventualisht në komunë apo organet administrative të prefekturës apo fylkes. Prefekti i prefekturës apo fylkes mbikqyrë dhe trajton ankesat sa i përket për shkollën fillore dhe se ky organ mund të kontaktohet.


### Informata nga interneti:

Informatat të përditshme për ngritjen e diturisë mund të gjeni në adresën vijuese:  
[www.kunnskapsloeftet.no](http://www.kunnskapsloeftet.no)

Informatat për mësimin themelues në gjuhën lapone mund të gjeni në adresën vijuese:  
[www.oahpponeahтта.no](http://www.oahpponeahтта.no)

Portali (në internet) i drejtoratit për arsim dhe shkencë për nxënës, mësues dhe udhëheqës shkollorë, prindër dhe kujdestarë dhe gjithë atyre të cilët janë të interesuar për shkollë dhe mësim është:  
[www.skolenettet.no](http://www.skolenettet.no)

Informata nga këshilli i prindërve për shkollën fillore (FUG):  
[www.foreldrenettet.no](http://www.foreldrenettet.no)





Published by:  
Ministry of Education and Research

Additional copies may be ordered from:  
Government Administration Services  
Kopi- og distribusjonsservice  
[www.publikasjoner.dep.no](http://www.publikasjoner.dep.no)  
E-mail: [publikasjonsbestilling@dss.dep.no](mailto:publikasjonsbestilling@dss.dep.no)  
Fax: + 47 22 24 27 86

Publication number: F-4209 Albansk  
Design: Tank  
Printed by: Kursiv Media AS - 11/2006  
Impression 300